

## Krimet naziste ndaj shqiptarëve

Vrasje,krime,luftë!

Gjyshi im më tregonte sa herë që luanim shah se si jeta dhe rutina e tij ishte gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore.Çdo gjë ishte si një mjergull dhe nuk mund të jetoje i qetë kur ishe nën komandën e dikujt.Sytë e tij mbusheshin me lot dhe fjalët që nxirrte nga goja dridheshin po njësoj si duart e tij.Unë e pyesja, ”Kaq shumë ndikim kanë pasur nazistët ndaj nesh?”

Në 7 prill 1938 agresioni fashist italian shënon pushtimin e Shqipërisë.Boshti Berlin-Romë-Tokio ishte dhe aleanca Gjermani-Itali-Japoni kundër Aleatëve të Mëdhenj dhe popujve të pafajshëm.Një tension i pashmangshëm dallohej mes kundërshtarëve ku diktatura mori fuqi dhe diktatorët pushtet.E gjithë bota u trazua por fatkeqësisht jo të gjithë shtetet kishin forca ushtarake për tu përqëndruar në luftë dhe t’ia hidhin paq.Në një anë ishin dhe krizat financiare,inflacioni dhe kushtet e këqija të jetesës që përkeqësoheshin dita ditës dhe pse ishin shkaqet kryesore që lufta nisi. Kur gjyshi më tregonte këtë histori unë e dëgjoja duke imagjinuar sesi do mund të jetoja në atë periudhë dhe pse më dukej e pamundur.Gjyshi im e përshkruante me dhimbje momentin kur nazistët arritën në Shqipëri.Duke krijuar një katrahurë ,duke përdorur dhunë,duke shkatërruar qytete,duke vendosur zjarre,duke vrarë njerëz dhe duke u rrafshuar çdo gjë që shqiptarët kishin ngritur për vite.

Ai në atë kohë ka strehuar në shtëpi një familje hebreje.I strehoi dhe i ruajti me sa të kishte mundësi.Ishin një familje prej katër antarësh mirëpo ishin strehuar dhe më parë në familje të tjera shqiptare duke i shtyrë frika ta bënin atë gjë.Kur trokitën në derën e gjyshit tim, prindërit e gjyshit i mirëpritën dhe i dhanë besën për ti mbrojtjur deri në vdekje.Ata i besuan menjëherë sepse fjala e shqiptarit është më e fortë se vdekja.Familja hebreje u mësua aty dhe ndiheshin mjaft komodë por deri në momentin që nazistët filluan kontrollin e tyre nëse ishin të strehuar nëpër familje shqiptare dhe nëse po ti merrnin me vete.Familja e gjyshit tim mori kurajon dhe i rregulloi një vend të fshehtë në bahcen e shtëpisë në rast se nazistët do të dyshonin megjithëse mund të dënoheshin për këtë gjë.Plani i tyre funksionoi. Ata nuk gjenin fjale për të përshkruar gëzimin e tyre dhe se sa mirënjohes ishin.Pavarësisht



humbjeve të mëdha materiale shqiptarët kurrë nuk e humbën besën,kulturën dhe vlerat e tyre të shenjta.

Fqinjët e gjyshit tim dhe shumë familje të tjera shqiptare ishin të lodhur nga ajo situatë.Po mendonin cdo ditë si të largoheshin drejt një vendi ku kishte paqe por ishte e pamundur sepse e gjithë bota ishte në luftë.Ata nuk mund ta shihnin Shqipërinë aq te errët,aq gri,aq te zbehtë dhe të pambrojtur. Shqipëria tyre ka pasur një ngrohtësi që nazistët e shkelën atë.Shihje fëmijë që qanin dhe nëna që luteshin që kjo luftë dhe ky makth të merrte fund por kur bëhej fjalë për nazistët ishte ndryshe megjithëse ata nuk kishin interesa afatgjate në Shqipëri,prandaj u tregua më e butë sesa vendet e tjera që kishin pushtuar.Te mos pasurit nje forcë ushtarake ndikoi në një mënyrë të madhe dhe ajo ishte arsyeja kryesore e humbjeve tona duke u raportuar rreth 60.000 shtëpi te shkatërruara dhe rreth 10% e popullsisë e lënë e pastrehë gjithashtu duke u shpallur një ndër vendet më të rrënuara në Europë.

Tepër e vështire të merrje frymë me frikën e të jetuarit jetën por nuk ishte zgjedhja e njerëzve të thjeshtë ,e atyre që donin paqe e mbi te gjitha lumturi në familjet e tyre.Në ato lloj situatash plumbi godet të drejtat dhe detyrimet...i jepet kurora skllavërisë e dhunës.Megjithëse shpresa dhe besimi i mbajnë gjallë njerëzit e sidomos shqiptarët.Dhe pse jemi perballur shpesh dhe jemi quajtur një vend ekonomikisht,ushtarakisht,politikisht I dobët por jemi përsëri ne që kemi qëndruar të fortë dhe kemi ecur përpara duke shëruar plagët e te shkuarës.Paqja është celësi i lumturisë dhe mirëqënies së njeriut dhe nëse ne nuk e përfundojmë luftën,lufta do të na përfundojë neve.

Punoi:**Grejsi Allushi**

Shkolla:**"Sami Frashëri"**

**KLASA:11-14**